



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.20/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët : Skender Çoçaj kryesues, Arsim Hamzaj dhe Kymete Kicaj, anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Bashkim Fazliu kandidat i pavarur, parashtruar kundër Vendimit Nr.01/2348/2025 të datës 06.09.2025 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për Miratimin e Rekomandimit të përbërjes së Këshillave të vendvotimeve të Rregullta dhe me Kusht, për Zgjedhjet Lokale, që do të mbahen më 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 10.09.2025, merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET E PABAZUAR ankesa ZL.Anr.20/2025 e datës 08.09.2025, e parashtruar nga Bashkim Fazliu kandidat i pavarur, me të cilën ka kërkuar që të obligoj KQZ, që të anuloh vendimin Nr.01/2348/2025 datë 06.09.2025 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për Miratimin e Rekomandimit të përbërjes së Këshillave të vendvotimeve të Rregullta dhe me Kusht për Zgjedhjet Lokale, për Zgjedhjet Lokale, që do të mbahen më 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datë 08.08.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesë nga Bashkim Fazliu si kandidat i pavarur, parashtruar kundër Vendimit Nr.01/2348/2025 të datës 06.09.2025 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për Miratimin e Rekomandimit të përbërjes së Këshillave të vendvotimeve të Rregullta dhe me Kusht, për Zgjedhjet Lokale, që do të mbahen më 12 Tetor 2025.

Në ankesë ndër të tjera thuhet se me datë 08.09.2025, përmes viberit ka pranuar formulën për anëtarë të KVV-së, për Zgjedhjet Lokale në Ferizaj.

Më tej parashtruesi i ankesës thekson se si subjekt politik i janë ndarë vetëm 2 vende nga 616 vendeve gjithsej, që në përqindje i bjen 0.32%. Dmth një ndarje nënçmuese dhe qesharake, njëkohësisht edhe diskriminuese. Ndërsa ka subjekte tjera të cilave u janë caktuar 30 anëtarë (URA) dhe 20 anëtarë Vatra, ndërsa nuk janë në Asamble e as Kuvend të Kosovës.

Sipas parashtruesit të ankesës me këtë ndarje diskriminuese është shkelur neni 74 paragrafi 1 dhe 76 paragrafi 2 i Ligjit për Zgjedhje të Përgjithshme nr. 08/L-228. Andaj kërkoj ndarje të barabartë të vendeve të mbetura për subjektet politike jo-anëtare të Kuvendit, 52 vende të ndahen barabartë.

Parashtruesi në ankesë ka bashkangjitur listën për miratimin e rekomandimit për Emërimin e Anëtarëve të Komisioneve Komunal të Zgjedhjeve-KVV.

Në përgjigje në ankesë KQZ-ja sqaron se gjatë vendimmarrjes për përbërjen e Këshillave të Vendvotimeve të Rregullta dhe me Kusht ka marr për bazë nenin 64 paragrafi 2.10, nenin 75,76 dhe 77 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe nenin 2 paragrafi 2, 3 dhe 43 neni 3 paragrafi 1, paragrafi 2, nën paragrafi 2.1. dhe 2.2, paragrafi 1,2,3 dhe 4 dhe neni 3 parafi 1,2 nën paragrafi 2.1 dhe 2.2 të Rregullores Zgjedhore Nr.11/2024 Këshillat e Vendvotimeve.

Pretendimet e palës ankuese se vendimi i KQZ, nr. 01/2348-2025, për Miratimin e Rekomandimit për Përbërjen e Këshillave të Vendvotimeve të Rregullta dhe me Kusht për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, që do të mbahen më 12 tetor 2025 se ndarja e KVV në komunën e Ferizajt është diskriminuese ndaj tij pasi që janë caktuar vetëm 2 anëtar të KVV-ve.

Pretendimet e palës ankuese janë të pa bazuara për arsyeje se KQZ gjatë ndarjes së vendeve në Këshillat e Vendvotimeve është mbështetur në nenin 3 paragrafi 1 Rregullores Zgjedhore Nr.11/2024, për Këshillat e Vendvotimeve, sipas të cilit përfaqësimi në KVV u takon:

Subjektet politike që kanë kaluar pragun zgjedhor në zgjedhjet e fundit nacionale kanë të drejtë të përfaqësohen me nga një anëtar në KVV .

Kandidati i pavarur i zgjedhur Kryetar Komune në zgjedhjet e fundit, në rast se garon sërish, ka të drejtë të përfaqësohet me një anëtar në KVV.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, sipas nevojës, mund ta rrisë ose ta zvogëlojë numrin e anëtarëve të KVV-së deri në dy (2) anëtarë në KVV.

KVV reflekton strukturën e anëtarëve të Komisionit Komunal të Zgjedhjeve (KKZ).

Edhe në rastin kur kjo është realizuar, KQZ ka vazhduar duke marr për bazë kriteret tjera:

KQZ, në bazë të formulës përkatëse, përfshin edhe subjektet politike të përfaqësuara në Kuvendin e Komunës, duke u bazuar në përqindjen e votave të fituara .

Nëse nuk arrihet të plotësohet numri prej pesë (5) anëtarësh në KVV, KQZ mund të kërkojë nominime plotësuese nga subjektet politike të certifikuara ne zgjedhjet qe planifikohen te mbahen (12 Tetori).

KKZ ka të drejtë t'i rekomandojë KQZ-së për nominimin e personave me përvojë në proceset zgjedhore, në rast se numri i anëtarëve të KVV-së nuk plotësohet.

KQZ ka marrë për bazë edhe paragrafin 4 të nenit 77, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, i cili i jep kompetencë KQZ që pavarësisht paragrafit paraprak të këtij neni, në rast se kërkohet, KQZ ka kompetenca për të emëruar sipas zgjedhjes së saj anëtarët e KW-ve të cilët nuk përmbushin kushtet sipas këtij neni.

KQZ, kandidatit të pavarur, Bashkim Fazliu në komunën e Ferizajt i ka ndarë 2 anëtar të KVV-ve. KQZ në këtë rast në kuadër me qellim të gjithë përfshirjes i ka ndarë dy anëtar të KVV-ve kandidatit të lartcekur edhe përkundër faktit se nuk i përmbush kriteret e kërkuara me aktet e KQZ.

Ndërsa sa i përket pretendimit në lidhje se duhet të jetë i barabartë me subjektin politik VATRA e Cila kandidon me 10 anëtar për kuvendin e komunës dhe iniciativën qytetare URA e Cila po ashtu kandidon me 10 anëtar për kuvendin e komunës nuk qëndron për faktin se rregullorja nr. 11/2024, neni 3 paragrafi 5 i jep hapësirë KQZ që "nëse nuk arrihet të plotësohet numri prej pesë (5) anëtarësh në KVV, KQZ mund të kërkojë nominime plotësuese nga subjektet politike të certifikuara".

Paneli, pas shqyrtimit të ankesës së parashtruar nga ankuesi, gjeti se :

-Ankesa është e pabazuar.

Paneli e vlerësoj lejueshmërinë e ankesës dhe ka ardhur në përfundim se e njëjta i plotëson kushtet e përcaktuara me nenin 77 paragraf 5 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, dhe nenin 4 të Rregullores Nr.01/2025, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave.

Pretendimet e palës ankuese se Vendimi Nr.01/2348/2025 të datës 06.09.2025, për Miratimin e Rekomandimit të përbërjes së Këshillave të vendotimeve të Rregullta dhe me Kusht, se KQZ me vendimin e kontestuar ka bërë diskriminim në ndarjen të këtyre vendeve ku si subjekt politik i'u janë caktuar vetëm 2 anëtarë, dhe si i tillë është në kundërshtim me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Paneli i vlerësoj si të pabazuara për faktin se me dispozita ligjore janë përcaktuar qartë përbërjet dhe funksionet e KVV, ku shprehimisht dispozita e nenit 77 par.3 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, parasheh se *“Kryesuesit e këshillave të vendotimeve zgjidhen në mënyrë të barabartë në mesin e katër (4) subjekteve politike të certifikuara që kanë fituar numrin më të madh të votave për Kuvendin e Kosovës gjatë zgjedhjeve të fundit në atë komunë”*, ndërsa paragrafi 4 i këtij neni thekson se *“pavarësisht paragrafit paraprak të këtij neni, në rast se kërkohet, KQZ-ja, ka kompetenca për të emëruar sipas zgjedhjes së saj anëtarët e KVV-ve, të cilët nuk i përmbushin kushtet sipas këtij neni”*.

Bazuar në të lartcekurat paneli vlerëson se KQZ ka bërë shpërndarjen e KVV-ve në vendvotimet e rregullta, me kusht në bazë të kriterëve dhe kushteve të përcaktuara me ligj dhe aktet nënligjore ku ndarja është bërë duke trajtuar në mënyrë të barabartë për të gjitha subjektet politike në mënyrë që kjo përfshirje të reflektoj pjesëmarrjen e barabartë për të gjithë ata që marrin pjesë në procesin zgjedhor.

Përfundimisht paneli nga PZAP ka gjetur se KQZ-ja ka vendosur në mënyrë të drejtë dhe të barabartë për të gjitha subjektet politike, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, si për subjektet që kanë fituar numrin më të madh të votave në zgjedhjet e fundit, e po ashtu edhe për të gjitha subjektet tjera pjesëmarrëse dhe se mbi këtë arsye të njëjtave nuk iu është bërë ndonjë padrejtësi me vendimin Nr.01/2348/2025 të datës 06.09.2025 për Miratimin e Rekomandimit të përbërjes së Këshillave të vendotimeve të Rregullta dhe me Kusht në këtë kontekst duhet pasur parasysh edhe dispozitën ligjore nenin 77 par.4 të LZP-së e cila i jep të drejtë KQZ-së, për të emëruar anëtarë të KKV sipas zgjedhjes së saj, pa marrë parasysh numrin e votave të fituara në zgjedhjet e fundit.

Prandaj, nga arsyet e paraqitura më lart dhe në pajtim me nenin 13 paragrafi 2 të Rregullores së PZAP-it Nr.01/2025, për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, si dhe nenit 118 paragrafi 1 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, duke i refuzuar ankesën si të pabazuar.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZLA.nr.20/2025 datë 10.09.2025



KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 08/L – 228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AA.nr.79/2025

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Rrustem Thaqi kryetar i kolegjit, Franciska Zhitija - Ymeri dhe Muhamet Rexha, anëtarë, lidhur me ankesën Bashkim Fazliu, kandidat i pavarur, për Miratimin e Rekomandimit të përbërjes së Këshillave të vendotimeve të Rregullta dhe me Kusht, për Zgjedhjet Lokale, që do të mbahen më 12 Tetor 2025, të paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZL.Anr.20/2025, të datës 10.09.2025, në seancën e mbajtur më datë 15.09.2025, merr këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET ankesa e Bashkim Fazliu, kandidat i pavarur, ndërsa vendimi i Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZL.Anr.20/2025, i datës 10.09.2025, VERTETOHET.

A r s y e t i m i

Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, me vendimin ZL.Anr.20/2025, të datës 10.09.2025, ka vendosur: Refuzohet e pabazuar ankesa ZL.Anr.20/2025 e datës 08.09.2025, e parashtruar nga Bashkim Fazliu, kandidat i pavarur, me të cilën ka kërkuar që të obligoj KQZ, që të anuloj vendimin Nr.01/2348/2025 të datës 06.09.2025 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për Miratimin e Rekomandimit të përbërjes së Këshillave të vendotimeve të Rregullta dhe me Kusht për Zgjedhjet Lokale, për Zgjedhjet Lokale, që do të mbahen më 12 Tetor 2025.

Kundër vendimit të lartpërmendur, Bashkim Fazliu, kandidat i pavarur, ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme, me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij, duke pretenduar se vendimi është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat përkatëse të LZP-së, dhe vërtetimi i gabuar i gjendjes faktike, duke propozuar që Gjykata Supreme të aprovojë ankesën të shfuqizojë vendimin e PZAP-it, me nr.ZL.Anr. 20/2025, të datës 10.09.2025, të obligojë Komisionin Qendror të Zgjedhjeve që të korrigjojë menjëherë tabelën e shpërndarjes së anëtarëve të KVV-ve, për subjektet politike, ku 52 vende të ndahen baras mes URA, VATRA dhe Bashkim Fazliu.

Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të kontestuar, në kuptim të pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.



Nga shkresat e lëndës rezultojn se më datë 08.08.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesë nga Bashkim Fazliu, si kandidat i pavarur, parashtruar kundër Vendimit Nr.01/2348/2025 të datës 06.09.2025 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për Miratimin e Rekomandimit të përbërjes së Këshillave të vendvotimeve të Rregullta dhe me Kusht, për Zgjedhjet Lokale, që do të mbahen më 12 Tetor 2025.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka ushtruar përgjigje në ankesë, me të cilën e ka kundërshtuar në tërësi ankesën e nga Bashkim Fazliu, si kandidat i pavarur.

Pas pranimit të përgjigjes në ankesë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, PZAP-i, ka nxjerr vendimin ZL.Anr.20/2025, të datës 10.09.2025, me të cilën e ka refuzuar ankesën e Bashkim Fazliu, si kandidat i pavarur, duke vendosur si në dispozitiv të vendimit.

PZAP, në arsyetim të vendimit të saj ndër të tjera ka theksuar se: pretendimet e palës ankuese se vendimi Nr.01/2348/2025 i datës 06.09.2025, për Miratimin e Rekomandimit të përbërjes së Këshillave të vendvotimeve të Rregullta dhe me Kusht, se KQZ, me vendimin e kontestuar ka bërë diskriminim në ndarjen të këtyre vendeve ku si subjekt politik i'u janë caktuar vetëm 2 anëtarë, dhe si i tillë është në kundërshtim me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Paneli, i ka vlerësuar si të pabazuara për faktin se me dispozita ligjore janë përcaktuar qartë përbërjet dhe funksionet e KVV, ku shprehimisht dispozita e nenit 77 paragrafi 3 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, parasheh se: “Kryesuesit e këshillave të vendvotimeve zgjidhen në mënyrë të barabartë në mesin e katër (4) subjekteve politike të certifikuara që kanë fituar numrin më të madh të votave për Kuvendin e Kosovës gjatë zgjedhjeve të fundit në atë Komunë”, ndërsa paragrafi 4 i këtij neni thekson se: “pavarësisht paragrafit paraprak të këtij neni, në rast se kërkohet, KQZ-ja, ka kompetenca për të emëruar sipas zgjedhjes së saj anëtarët e KVV-ve, të cilët nuk i përmbushin kushtet sipas këtij neni”.

Bazuar në të lartcekurat paneli vlerëson se KQZ ka bërë shpërndarjen e KVV-ve në vendvotimet e rregullta, me kusht në bazë të kriterëve dhe kushteve të përcaktuara me ligj dhe aktet nënligjore ku ndarja është bërë duke trajtuar në mënyrë të barabartë për të gjitha subjektet politike në mënyrë që kjo përfshirje të reflektoj pjesëmarrjen e barabartë për të gjithë ata që marrin pjesë në procesin zgjedhor.

Përfundimisht PZAP, ka gjetur se KQZ-ja, ka vendosur në mënyrë të drejtë dhe të barabartë për të gjitha subjektet politike, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, si për subjektet që kanë fituar numrin më të madh të votave në zgjedhjet e fundit, e po ashtu edhe për të gjitha subjektet tjera pjesëmarrëse dhe se mbi këtë arsye të njëjtave nuk iu është bërë ndonjë padrejtësi me vendimin Nr.01/2348/2025 të datës 06.09.2025 për Miratimin e Rekomandimit të përbërjes së Këshillave të vendvotimeve të Rregullta dhe me Kusht në këtë kontekst duhet pasur parasysh edhe dispozitën ligjore nën 77 paragrafi 4 të LZP-së, e cila i jep të drejtë KQZ-së, për të emëruar anëtarë të KKV sipas zgjedhjes së saj, pa marrë parasysh numrin e votave të fituara në zgjedhjet e fundit.

Prandaj, nga arsyet e paraqitura më lart dhe në pajtim me nenin 13 paragrafi 2 të Rregullores së PZAP-it Nr.01/2025, për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, si dhe nenin 118 paragrafi i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, duke i refuzuar ankesën si të pabazuar.



Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë faktike dhe ligjore e çështjes, e pranon në tërësi si të drejtë dhe të bazuar qëndrimin juridik të PZAP-it, si në vendimin e tij, lidhur me Miratimin e Rekomandimit të përbërjes së Këshillave të vendvotimeve të Rregullta dhe me Kushtet për Zgjedhjet Lokale, që do të mbahen më 12 Tetor 2025. Vendimi i PZAP, është i drejtë i kuptueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare nga vërtetohet se edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë në kuptim të dispozitave ligjore të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, dhe Rregullores Nr.01/2025, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia me të drejtë ka vendosur kur e ka refuzuar ankesën e kandidatit të pavarur Bashkim Fazliu dhe drejtë ka zbatuar të drejtën materiale për arsye se:

Me nenin 74 paragrafi 1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, përcaktohet se: 1. Përbërja e Këshillit të Vendvotimit reflekton strukturën e anëtarëve të KKZ-së. Komisioni Komunal i Zgjedhjeve mundet, në raste të veçanta, ta shtojë numrin e anëtarëve në Këshillin e Vendvotimit dhe për këtë menjëherë ta njoftojë KQZ-në.

Me nenin 76 paragrafi 2 dhe 3 të këtij ligji përcaktohet se: “2. Në kohën e përcaktuar nga KQZ-ja, SKQZ-ja i fton të gjitha subjektet politike të certifikuara, të përfaqësuara në kuvendin komunal, të cilat garojnë në zgjedhjet shtetërore, t’i dorëzojnë në KKZ propozimet për personat që ata dëshirojnë t’i emërojnë anëtarë të KVV-ve të formuara në kuadër të komunës së tyre. 3. SKQZ-ja kërkon nga subjektet politike të reja, OJQ-të dhe organizatat tjera qytetare t’i dorëzojnë nominimet plotësuese për KVV”.

Me nenin 77 paragrafi 1 pika 1.1, 1.2, 1.3, dhe 1.4, dhe paragrafi 4 të këtij ligji, përcaktohet se: “1. Menjëherë pas pranimit të të gjitha nominimeve, KKZ-të i caktojnë të emëruarit në VV-të e propozuara për ta duke e zbatuar grupin e rregullave në vijim: 1.1. jo më shumë se një person prej një listë të nominimeve në KVV, të dorëzuar sipas nenit 76 paragrafi 2 të këtij ligji, të emërohet anëtar i KVV-së në të njëjtin VV; 1.2. gjatë përzgjedhjes së kandidatëve nga lista e nominimeve të KVV-së të dorëzuar sipas nenit 76 paragrafi 3 të këtij ligji, përparësi u jepet kandidatëve me cilësi më të mira dhe veçanërisht atyre me përvojë paraprake në zgjedhje; 1.3. jo më shumë se një person nga familja e ngushtë mund të emërohet në të njëjtin KVV. Për qëllime të këtij neni, familja e ngushtë përfshinë bashkëshortin/ën, fëmijët, prindërit dhe vëllezërit e motrat; 1.4. në komunat e reja ose aty ku nuk janë certifikuar rezultatet nga zgjedhjet e kaluara, anëtarësia e KVV-ve përzgjidhet me short ndërmjet atyre subjekteve politike të certifikuara për pjesëmarrje në zgjedhjet e ardhshme në atë komunë. 4. Pavarësisht paragrafit paraprak të këtij neni, në rast se kërkohet, KQZ-ja ka kompetenca për të emëruar sipas zgjedhjes së saj anëtarët e KVV-ve të cilët nuk përmbushin kushtet sipas këtij neni.”.

Me nenin 3 paragrafi 1, 3, 4, 5 dhe 6 të Rregullores Zgjedhore nr.11/2024 Këshillat e Vendvotimeve, përcaktohet se: “1. KQZ fton subjektet politike të certifikuara të cilat kanë kaluar pragun zgjedhor në zgjedhjet e fundit nacionale, që të nominojnë nga një (1) anëtar për KVV. 3. Subjektet politike të certifikuara, të cilat janë të përfaqësuara në nivel komunal, por që nuk përfshihen në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni, ftohen që t’i dorëzojnë propozimet për anëtarë të KVV, sipas numrit të përcaktuar nga KQZ, sipas formulës për përfaqësim, e bazuar në përqindjen e votave të fituara në kuvendin komunal. 4. Në rast se kandidati i pavarur i zgjedhur si kryetar i komunës në zgjedhjet e fundit, garon sërish në zgjedhje për kryetar



komune si kandidat i pavarur, të njëjtit i garantohet përfaqësimi me nga një (1) anëtar të KVV, në secilën KVV në atë komunë. 5. Nëse nuk plotësohet numri prej pesë (5) anëtarëve të KVV, KQZ mund të kërkojë nominime plotësuese nga subjektet politike të reja, të certifikuara për zgjedhje dhe organizatat jo qeveritare (OJQ), të cilat nuk monitorojnë zgjedhjet. 6. Në rastet e jashtëzakonshme, nëse numri i anëtarëve të KVV nuk arrihet të plotësohet sipas paragrafit 5 të këtij neni, KKZ mund t'i rekomandojë KQZ-së nominimin e personave të cilët kanë përvojë zgjedhore”.

Andaj nga dispozita e lartcekur shihet qartë se anëtarët e këshillave të vendotimeve zgjidhen në mënyrë të barabartë nga subjektet politike të certifikuara, të përfaqësuara në Kuvendin Komunal, të cilat garojnë në zgjedhjet shtetërore në zgjedhjet komunale, ndërsa përjashtim bënë paragrafi 4 i nenit 77 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, ku i jep të drejtë KQZ-së që nëse kërkohet numër më i madh i anëtarëve të këshillave të bëjë përzgjedhjen sipas vlerësimit të saj. Në këtë rast KQZ-ja, duke vepruar sipas dispozitës së lartcekur ka bërë përzgjedhjen e anëtarëve duke bërë përzgjedhjen edhe sipas propozimit të kandidatit të pavarur Bashkim Fazliu, ku në Komunën e Ferizajt i ka ndarë dy anëtar në KVV, edhe përkundër faktit se nga dispozitat ligjore të lartcekura të njëjtit nuk i takojnë këto vende.

Në raport me pretendimet e kandidatit të pavarur në ankesë së PZAP-i, me rastin e refuzimit të ankesës ka vepruar në kundërshtim me nenin 74 dhe 76 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe në kundërshtim me nenin 24 dhe 45 të Kushtetutës së Kosovës, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se këto pretendime janë të pa bazuara. Në rastin konkret rezulton fakti se parashtruesi i ankesës është kandidat i pavarur dhe nuk është subjekt politik i regjistruar në KQZ, sipas procedurave ligjore, dhe i certifikuar, ndërsa sipas dispozitave ligjore parimisht anëtarët për KVV, i takojnë subjekteve politike të regjistruara, ndërsa përjashtimisht nëse nuk plotësohen vendet, i jepet të drejtë KQZ-së, që sipas vlerësimit të saj të bëjë përzgjedhjen edhe të anëtarëve të tjerë, që në këtë rast KQZ-ja, i ka përzgjedhur dy anëtarë sipas propozimit të kandidatit të pavarur Bashkim Fazliu edhe për kundër faktit se me dispozita ligjore nuk ka qenë e obliguar ta bëjë një gjë të tillë.

Nisur nga gjendja faktike e vërtetuar, kjo gjykatë konstatoi se në këtë çështje juridike, gjendja faktike është vërtetuar drejt dhe nuk është shkelur ligji në dëm të parashtruesit të ankesës, prandaj, pretendimet në ankesë lidhur me refuzimin e ankesës u refuzuan si të pa bazuara sepse si të tilla nuk dëshmuuan se përmbushin shkaqet për të cilat mund të paraqitet ankesa që të prezantohen fakteve të reja nga pala e interesuar dhe, nuk u gjetën shkelje procedurale e as ndonjë gabim faktik i cili ndikon në të drejtat e palës apo ligjshmërinë e procedurës.

Nga theksimet si më lartë dhe në bazë të nenit 118 paragrafi 1, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

AA.nr.79/2025, datë 15.09.2025.



Republika e Kosovës



Republika Kos

SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
TACNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE

Punëtori i autorizuar
Ovláscení radník

Kryetari i kolegjit,

Rrustem Thaqi



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AA.nr.79/2025

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Rrustem Thaqi kryetar i kolegjit, Franciska Zhitija - Ymeri dhe Muhamet Rexha, anëtarë, lidhur me ankesën Bashkim Fazliu, kandidat i pavarur, për Miratimin e Rekomandimit të përbërjes së Këshillave të vendotimeve të Rregullta dhe me Kusht, për Zgjedhjet Lokale, që do të mbahen më 12 Tetor 2025, të paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZL.Anr.20/2025, të datës 10.09.2025, në seancën e mbajtur më datë 15.09.2025, merr këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET ankesa e Bashkim Fazliu, kandidat i pavarur, ndërsa vendimi i Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZL.Anr.20/2025, i datës 10.09.2025, VERTETOHET.

A r s y e t i m i

Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, me vendimin ZL.Anr.20/2025, të datës 10.09.2025, ka vendosur: Refuzohet e pabazuar ankesa ZL.Anr.20/2025 e datës 08.09.2025, e parashtruar nga Bashkim Fazliu, kandidat i pavarur, me të cilën ka kërkuar që të obligoj KQZ, që të anuloj vendimin Nr.01/2348/2025 të datës 06.09.2025 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për Miratimin e Rekomandimit të përbërjes së Këshillave të vendotimeve të Rregullta dhe me Kusht për Zgjedhjet Lokale, për Zgjedhjet Lokale, që do të mbahen më 12 Tetor 2025.

Kundër vendimit të lartpërmendur, Bashkim Fazliu, kandidat i pavarur, ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme, me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij, duke pretenduar se vendimi është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat përkatëse të LZP-së, dhe vërtetimi i gabuar i gjendjes faktike, duke propozuar që Gjykata Supreme të aprovojë ankesën të shfuqizojë vendimin e PZAP-it, me nr.ZL.Anr. 20/2025, të datës 10.09.2025, të obligojë Komisionin Qendror të Zgjedhjeve që të korrigjojë menjëherë tabelën e shpërndarjes së anëtarëve të KVV-ve, për subjektet politike, ku 52 vende të ndahen baras mes URA, VATRA dhe Bashkim Fazliu.

Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të kontestuar, në kuptim të pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.



Nga shkresat e lëndës rezulton se më datë 08.08.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesë nga Bashkim Fazliu, si kandidat i pavarur, parashtruar kundër Vendimit Nr.01/2348/2025 të datës 06.09.2025 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për Miratimin e Rekomandimit të përbërjes së Këshillave të vendvotimeve të Rregullta dhe me Kusht, për Zgjedhjet Lokale, që do të mbahen më 12 Tetor 2025.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka ushtruar përgjigje në ankesë, me të cilën e ka kundërshtuar në tërësi ankesën e nga Bashkim Fazliu, si kandidat i pavarur.

Pas pranimit të përgjigjes në ankesë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, PZAP-i, ka nxjerr vendimin ZL.Anr.20/2025, të datës 10.09.2025, me të cilën e ka refuzuar ankesën e Bashkim Fazliu, si kandidat i pavarur, duke vendosur si në dispozitiv të vendimit.

PZAP, në arsyetim të vendimit të saj ndër të tjera ka theksuar se: pretendimet e palës ankuese se vendimi Nr.01/2348/2025 i datës 06.09.2025, për Miratimin e Rekomandimit të përbërjes së Këshillave të vendvotimeve të Rregullta dhe me Kusht, se KQZ, me vendimin e kontestuar ka bërë diskriminim në ndarjen të këtyre vendeve ku si subjekt politik i'u janë caktuar vetëm 2 anëtarë, dhe si i tillë është në kundërshtim me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Paneli, i ka vlerësuar si të pabazuara për faktin se me dispozita ligjore janë përcaktuar qartë përbërjet dhe funksionet e KVV, ku shprehimisht dispozita e nenit 77 paragrafi 3 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, parashihet se: “Kryesuesit e këshillave të vendvotimeve zgjidhen në mënyrë të barabartë në mesin e katër (4) subjekteve politike të certifikuara që kanë fituar numrin më të madh të votave për Kuvendin e Kosovës gjatë zgjedhjeve të fundit në atë Komunë”, ndërsa paragrafi 4 i këtij neni thekson se: “pavarësisht paragrafit paraprak të këtij neni, në rast se kërkohet, KQZ-ja, ka kompetenca për të emëruar sipas zgjedhjes së saj anëtarët e KVV-ve, të cilët nuk i përmbushin kushtet sipas këtij neni”.

Bazuar në të lartcekurat paneli vlerëson se KQZ ka bërë shpërndarjen e KVV-ve në vendvotimet e rregullta, me kusht në bazë të kriterëve dhe kushteve të përcaktuara me ligj dhe aktet nënligjore ku ndarja është bërë duke trajtuar në mënyrë të barabartë për të gjitha subjektet politike në mënyrë që kjo përfshirje të reflektoj pjesëmarrjen e barabartë për të gjithë ata që marrin pjesë në procesin zgjedhor.

Përfundimisht PZAP, ka gjetur se KQZ-ja, ka vendosur në mënyrë të drejtë dhe të barabartë për të gjitha subjektet politike, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, si për subjektet që kanë fituar numrin më të madh të votave në zgjedhjet e fundit, e po ashtu edhe për të gjitha subjektet tjera pjesëmarrëse dhe se mbi këtë arsye të njëjtave nuk iu është bërë ndonjë padrejtësi me vendimin Nr.01/2348/2025 të datës 06.09.2025 për Miratimin e Rekomandimit të përbërjes së Këshillave të vendvotimeve të Rregullta dhe me Kusht në këtë kontekst duhet pasur parasysh edhe dispozitën ligjore nën 77 paragrafi 4 të LZP-së, e cila i jep të drejtë KQZ-së, për të emëruar anëtarët të KKV sipas zgjedhjes së saj, pa marrë parasysh numrin e votave të fituara në zgjedhjet e fundit.

Prandaj, nga arsyet e paraqitura më lart dhe në pajtim me nenin 13 paragrafi 2 të Rregullores së PZAP-it Nr.01/2025, për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, si dhe nenin 118 paragrafi i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, duke i refuzuar ankesën si të pabazuar.



Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë faktike dhe ligjore e çështjes, e pranon në tërësi si të drejtë dhe të bazuar qëndrimin juridik të PZAP-it, si në vendimin e tij, lidhur me Miratimin e Rekomandimit të përbërjes së Këshillave të vendotimeve të Rregullta dhe me Kusht për Zgjedhjet Lokale, që do të mbahen më 12 Tetor 2025. Vendimi i PZAP, është i drejtë i kuptueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare nga vërtetohet se edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë në kuptim të dispozitave ligjore të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, dhe Rregullores Nr.01/2025, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendorsjes së Ankesave.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia me të drejtë ka vendosur kur e ka refuzuar ankesën e kandidatit të pavarur Bashkim Fazliu dhe drejtë ka zbatuar të drejtën materiale për arsye se:

Me nenin 74 paragrafi 1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, përcaktohet se: 1. Përbërja e Këshillit të Vendotimit reflekton strukturën e anëtarëve të KKZ-së. Komisioni Komunal i Zgjedhjeve mundet, në raste të veçanta, ta shtojë numrin e anëtarëve në Këshillin e Vendotimit dhe për këtë menjëherë ta njoftojë KQZ-në.

Me nenin 76 paragrafi 2 dhe 3 të këtij ligji përcaktohet se: “2. Në kohën e përcaktuar nga KQZ-ja, SKQZ-ja i fton të gjitha subjektet politike të certifikuar, të përfaqësuara në kuvendin komunal, të cilat garojnë në zgjedhjet shtetërore, t’i dorëzojnë në KKZ propozimet për personat që ata dëshirojnë t’i emërojnë anëtarë të KVV-ve të formuara në kuadër të komunës së tyre. 3. SKQZ-ja kërkon nga subjektet politike të reja, OJQ-të dhe organizatat tjera qytetare t’i dorëzojnë nominimet plotësuese për KVV”.

Me nenin 77 paragrafi 1 pika 1.1, 1.2, 1.3, dhe 1.4, dhe paragrafi 4 të këtij ligji, përcaktohet se: “1. Menjëherë pas pranimit të të gjitha nominimeve, KKZ-të i caktojnë të emëruarit në VV-të e propozuara për ta duke e zbatuar grupin e rregullave në vijim: 1.1. jo më shumë se një person prej një listë të nominimeve në KVV, të dorëzuar sipas nenit 76 paragrafi 2 të këtij ligji, të emërohet anëtar i KVV-së në të njëjtin VV; 1.2. gjatë përzgjedhjes së kandidatëve nga lista e nominimeve të KVV-së të dorëzuar sipas nenit 76 paragrafi 3 të këtij ligji, përparësi u jepet kandidatëve me cilësi më të mira dhe veçanërisht atyre me përvojë paraprake në zgjedhje; 1.3. jo më shumë se një person nga familja e ngushtë mund të emërohet në të njëjtin KVV. Për qëllime të këtij neni, familja e ngushtë përfshinë bashkëshortin/ën, fëmijët, prindërit dhe vëllezërit e motrat; 1.4. në komunat e reja ose aty ku nuk janë certifikuar rezultatet nga zgjedhjet e kaluara, anëtarësia e KVV-ve përzgjidhet me short ndërmjet atyre subjekteve politike të certifikuar për pjesëmarrje në zgjedhjet e ardhshme në atë komunë. 4. Pavarësisht paragrafit paraprak të këtij neni, në rast se kërkohet, KQZ-ja ka kompetenca për të emëruar sipas zgjedhjes së saj anëtarët e KVV-ve të cilët nuk përmbushin kushtet sipas këtij neni.”.

Me nenin 3 paragrafi 1, 3, 4, 5 dhe 6 të Rregullores Zgjedhore nr.11/2024 Këshillat e Vendotimeve, përcaktohet se: “1. KQZ fton subjektet politike të certifikuar të cilat kanë kaluar pragun zgjedhor në zgjedhjet e fundit nacionale, që të nominojnë nga një (1) anëtar për KVV. 3. Subjektet politike të certifikuar, të cilat janë të përfaqësuara në nivel komunal, por që nuk përfshihen në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni, ftohen që t’i dorëzojnë propozimet për anëtarë të KVV, sipas numrit të përcaktuar nga KQZ, sipas formulës për përfaqësim, e bazuar në përqindjen e votave të fituara në kuvendin komunal. 4. Në rast se kandidati i pavarur i zgjedhur si kryetar i komunës në zgjedhjet e fundit, garon sërish në zgjedhje për kryetar



komune si kandidat i pavarur, të njëjtit i garantohet përfaqësimi me nga një (1) anëtar të KVV, në secilën KVV në atë komunë. 5. Nëse nuk plotësohet numri prej pesë (5) anëtarëve të KVV, KQZ mund të kërkojë nominime plotësuese nga subjektet politike të reja, të certifikuara për zgjedhje dhe organizatat jo qeveritare (OJQ), të cilat nuk monitorojnë zgjedhjet. 6. Në rastet e jashtëzakonshme, nëse numri i anëtarëve të KVV nuk arrihet të plotësohet sipas paragrafit 5 të këtij neni, KKZ mund t'i rekomandojë KQZ-së nominimin e personave të cilët kanë përvojë zgjedhore”.

Andaj nga dispozita e lartcekur shihet qartë se anëtarët e këshillave të vendotimeve zgjidhen në mënyrë të barabartë nga subjektet politike të certifikuara, të përfaqësuara në Kuvendin Komunal, të cilat garojnë në zgjedhjet shtetërore në zgjedhjet komunale, ndërsa përjashtim bënë paragrafi 4 i nenit 77 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, ku i jep të drejtë KQZ-së që nëse kërkohet numër më i madh i anëtarëve të këshillave të bëjë përzgjedhjen sipas vlerësimit të saj. Në këtë rast KQZ-ja, duke vepruar sipas dispozitës së lartcekur ka bërë përzgjedhjen e anëtarëve duke bërë përzgjedhjen edhe sipas propozimit të kandidatit të pavarur Bashkim Fazliu, ku në Komunën e Ferizajt i ka ndarë dy anëtar në KVV, edhe përkundër faktit se nga dispozitat ligjore të lartcekura të njëjtit nuk i takojnë këto vende.

Në raport me pretendimet e kandidatit të pavarur në ankesë së PZAP-i, me rastin e refuzimit të ankesës ka vepruar në kundërshtim me nenin 74 dhe 76 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe në kundërshtim me nenin 24 dhe 45 të Kushtetutës së Kosovës, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se këto pretendime janë të pa bazuara. Në rastin konkret rezulton fakti se parashtruesi i ankesës është kandidat i pavarur dhe nuk është subjekt politik i regjistruar në KQZ, sipas procedurave ligjore, dhe i certifikuar, ndërsa sipas dispozitave ligjore parimisht anëtarët për KVV, i takojnë subjekteve politike të regjistruara, ndërsa përjashtimisht nëse nuk plotësohen vendet, i jepet të drejtë KQZ-së, që sipas vlerësimit të saj të bëjë përzgjedhjen edhe të anëtarëve të tjerë, që në këtë rast KQZ-ja, i ka përzgjedhur dy anëtarë sipas propozimit të kandidatit të pavarur Bashkim Fazliu edhe për kundër faktit se me dispozita ligjore nuk ka qenë e obliguar ta bëjë një gjë të tillë.

Nisur nga gjendja faktike e vërtetuar, kjo gjykatë konstatoi se në këtë çështje juridike, gjendja faktike është vërtetuar drejt dhe nuk është shkelur ligji në dëm të parashtruesit të ankesës, prandaj, pretendimet në ankesë lidhur me refuzimin e ankesës u refuzuan si të pa bazuara sepse si të tilla nuk dëshmuuan se përmbushin shkaqet për të cilat mund të paraqitet ankesa që të prezantohen fakteve të reja nga pala e interesuar dhe, nuk u gjetën shkelje procedurale e as ndonjë gabim faktik i cili ndikon në të drejtat e palës apo ligjshmërinë e procedurës.

Nga theksimet si më lartë dhe në bazë të nenit 118 paragrafi 1, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

AA.nr.79/2025, datë 15.09.2025.



Republika e Kosovës



Republika Kosovo

Kryetari i kolegjit,
Rrustem Thaqi

SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
ТАЧНОТ ОТПРАВКА ПОТВРДУЈУЈЕ

Punëtori i autorizuar
Dvaščeni radnik



GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Sheji i shkresës
Oznaka spisa:

AA-79/2025

FLETËDËRGESË PËR DORËZIM PERSONAL DOSTAVNICA ZA LICNO DOSTAVLANJE

P ZAP. PRISATIN

(Të panevojshmeve bjeri vizë - nepotrebne precrtati)

1. Pasi marrësi, i cili me tentimin e parë të dorëzimit nuk u gjet në vendin e ku është dashtë të bëhet dorëzimi I sa pas lënjes së lajmërimit me shkrim që për shkak të dorëzimit të gjendet në kohën e caktuar në banesën apo në vendin e punës së tij, dorëzimi është bërë: anëtarit madhor të familjes së marrësit - kujdestarit të ndërtesës, fqijt, personit që punon po n'atë vend me marrësin.

1. Posto primilac, koji pri prvom pokusajo dostave nije zatecen na mestu gde se dostavljanje ima izvršiti ni posle ostavljenog pismenog obavestenja da radi dostavljanja bude u odredjeno vreme u svom stanu radnom mestu, dostava je izvršena: odraslom članu domacin. Primaoca nastojniku zgrace susedu licu zaposlenom na istom radnom mestu primaocem

2. Pasi marrësi ose anëtar i familjes së tij e refuzon marrjen e shkresës, shkresa u la në banesë në vendin e punës së marrësit (duke e ngjitur në derën e banesës ose të lokalit ku gjendet në punë marrësi).

2. Posto primilac odnosno clan njenog domacinstva odbio prijem, pismo je dostavljeno u stanu - radnom mestu primaoca (pribieno na vratima stana odnosno prostorije gde primilac zaposlen)

Më _____ 201 _____ në ora _____
dana _____ u _____ cas.

Shkaku i refuzimit të marrjes _____
Razlog adbijanja prijmea _____

Nënshkrimi i dorëzuesit - potpis dostavljacka

Emri i shkresës që dorëzohet:
Naslov pisma koja se dostavlja:

ARTGUKIM
15.09.2025

Numri i shtojcave: _____
broj priloga

Vërtetoi se mora shkresën e lartpërmendur
më (me fjalë)
Povrdujemo prijem gorenavegenog pisma
(i slovima)

AKUATI 15.09.2025

(Nënshkrimi i marrësit ose i atij që
e ka marrë aktin në vend të tij
Potpis primioca ili lica koje je
pismeno primilo u zamenu)

Nënshkrimi i dorëzuesit - potpis dostavljacka

Në rast se marrësi është analfabet ose nuk është në gjendje të nënshkruajë dorëzuesi, duhet shënuar shkaku pse marrësi nuk e ka vërtë nënshkruar e vet. Ako je primilac nepismen ili nije u stanju da se potpiše, potpisuje ga dostavljac, napomenom zasto primilac nije stavio svoj potpis.